



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:120138

Datë: 29.05.2023

Numri i dokumentit: 04335123

SCC-10-0398

Paditësit:

- 1. I G j B K.Gjakovë;**
- 2. A H B K.Gjakovë dhe**
- 3. R U B nga Gjakova, të cilët me autorizim H P av nga Gjakova**

Kundër

E paditura:

1.N.SH. “KBI Progres” - Prizren, e cila përfaqësohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarja Hajrie Shala kryesuese, Asllan Krasniqi dhe Agron Hoxhaj gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur 22 maj 2023, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM
PËR MOSPARAQITJE**

- 1. Padia hedhet poshtë.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore .**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me dt.21.12.2010, përfaqësuesi i autorizuar i paditësve ka ushtruar padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër te paditurës për vërtetimin e drejtës se pronësisë, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditësve. Paditësit kërkojnë vërtetimin e pronësisë ashtu

që të Vërtetohet se paditësi I B është pronar i parc.kad.nr.39 me kulturë mal, në sipërfaqe prej 6.00 ha, në vendin e quajtur “P i A” dhe të paluajtshmërisë me kulturë livadh në sipërfaqe prej 1,80.00 ha, në sipërfaqe të përgjithshme prej 7,80.00 ha ZK R; paditësi A B është pronar i parcelës kadastrale nr.39 me kulturë mal në sipërfaqe prej 6.00 ha , në vendin e quajtur “P i A” dhe të paluajtshmërisë me kulturë livadh në sipërfaqe prej 1,80.00 ha, në sipërfaqe të përgjithshme prej 7.80.00 ha ZK R, si dhe paditësit R B në parcelës kadastrale nr.39 në sipërfaqe prej 6.30 ha, me kulturë mal, në vendin e quajtur “P A” dhe të paluajtshmërisë me kulturë livadh në sip.prej 1.00.00 ha, dhe në sipërfaqe prej 1,50.00 ha me kulturë arë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 8,80.00 ha ZK Rugovë.

Paditësit e mbështesin pretendimin se paluajtshmërinë e kanë trashëguar nga paraardhësi i tyre.

Me padi ka parashtruar këto prova: Njoftimin për AKP dt.30.11.2010, Ekstrakt nga fletëposedimi nr.4915/10 dt.27.09.2010, Vendim nr.8754 dt.08.05.1946.

Me parashtrësën e dt.08.02.2011, i autorizuari i palës paditëse me parashtrësë ka bërë dorëzimin e Aktvendimit të trashëgimisë i të ndjerit Xh B T.nr.54/88 dt.31.03.1988, Vendimi i dt.09.06.1970. Kurse me parashtrësën e dt.28.02.2011, ka bërë dorëzimin e Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë C.nr.218/70 dt.09.06.1970.-fshihet

E paditura – AKP në mbrojtjen e saj të dt.23.12.2011 e ka kundërshtuar padinë e paditësve dhe ka theksuar se nga padia nuk mund të kuptohet se si paditësit e kanë humbur të drejtën e pronësisë. Gjithashtu, nuk ka dëshmi se si e kanë fituar të drejtën e pronësisë. Ka shtuar se Agjencia konsideron se edhe nëse supozohet fakti se vërtet parc.kad.nr.39 në të cilat paraardhësit e paditësve i kanë pasur në posedim faktik por për një periudhë të arsyeshme ligjore nuk kanë ngritur pretendimet e tyre në gjykatën kompetente për të fituar pronësinë juridike, bazuar në nenin 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar (Gaz.Zyr. RSFJ nr.53/76) e i cili ligj është i aplikueshëm në bazë të rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 për ligjin në fuqi në Kosovë, e kanë humbur pronësinë sipas këtyre dispozitave: *“nëse paluajtshmëria është bërë mjet në pronësi shoqërore pa bazë juridike, kthimi i saj mund të kërkohet në afat prej 5 viteve, duke filluar nga dita e njoftimit, kurse më së voni në afat prej 10 vitesh.”* Kështu mbi këtë bazë juridike kërkesa për të kërkuar kthimin eventual të pronësisë është parashkruar. Në përfundim në mbrojtjen e AKP- së kërkohet që padia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar.

Me dt.29.12.2011 e paditura “KBI PROGRES” ka paraqitur përgjigje në padi, në të cilën ndër të tjera ka theksuar se padia e paditësve është e pa plotë dhe e paqartë në kuptim të nenit 253 alineja 1 pika e), dhe e ka kontestuar padinë e paditësve duke theksuar se të njëjtëve u mungon legjitimitetit aktiv i paditësve si dhe ka shtuar se i mungon legjitimitetit pasiv ngase nuk ekziston asnjë organizatë me emrin e të paditurës. Ka kontestuar edhe pretendimet se paditësit e kanë paluajtshmërinë në posedim. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj padinë e paditësve.

Me dt.16.05.2023, gjykata ka caktuar seancën dëgjimore. Nga shkresat e lëndës rezulton se me dt.26.04.2023 i autorizuari i paditësve e ka pranuar thirrjen për seancë gjyqësore. Seanca

është mbajtur me datën e caktuar ku ishin prezent përfaqësuesi i palës së paditur, ndërsa përfaqësuesi i palës paditëse nuk ka prezentuar.

Përfaqësuesi i AKP-së, në fjalën e tij deklaroi se meqenëse i autorizuari i paditësve është ftuar në mënyrë të rregullte në seancë, propozoi që të nxjerrët aktgjykim për mosparaqitje në kuptim të nenit 58 të Ligjit për DHPGJS.

Arsyetimi Ligjor:

Sipas nenit 58 par.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme parashihet: *“Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës, mund pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale”.*

I autorizuari i palës paditëse është ftuar në mënyrë të rregullt për seancën dëgjimore të caktuar për datën 16 maj 2023. Megjithatë, edhe pse e ka pranuar thirrjen e dërguar nëpërmjet shërbimit postar, i njëjti e ka pranuar thirrjen mirëpo nuk është paraqitur në seancën dëgjimore. Pasi që DHPGJS nuk ka pranuar asnjë njoftim me të cilin do të theksonte (si të bazuar) rrethanat të cilat ia kanë pamundësuar prezencën në seancë si dhe duke pasur parasysh kërkesën e përfaqësuesit të palës së paditur që të merret aktgjykim në mungesë, Gjykata vlerëson se kushtet e parapara në nenin 58 par.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, janë përmbushur.

Andaj nga sa u tha më lartë, u vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Paditësi ka paguar taksat gjyqësore me rastin e parashtrimit të padisë, ashtu që secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Në pajtim me nenin 59 të Ligjit për Dhomën e posaçme, cilado palë mund të parashtrojë një kërkesë në DHPGJS për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje.

Kërkesa për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje duhet të parashtrohet brenda 1 (një) muaji nga dita e dorëzimit të aktgjykimit për mosparaqitje te pala gjegjëse.

Hajrie Shala Gjyqtare Kryesuese

Asllan Krasniqi Gjyqtar

Numri i lëndës: 2023:120138
Datë: 29.05.2023
Numri i dokumentit: 04335123

Agron Hoxhaj Gjyqtar